



A.nr.492/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.492/2026, të datës 30.04.2026, të parashtruar nga ankuesi A.L. nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit: Kuvendi i Republikës së Kosovës, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme, më datë 30.06.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.492/2026, e datës 30.04.2026, e parashtruar nga ankuesi A.L.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr. 10-V-007, i datës 30.03.2026, i Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi A.L. (në *tekstin e mëtejme referuar*: Ankuesi), me datë 30.04.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.10-V-007, të datës 30.03.2026, të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në *tekstin e mëtejme referuar*: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave më datë 05.05.2026, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa, ky i fundit më datë 14.05.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në *tekstin e mëtejme referuar*: Kolegji i Këshillit) si prova i administroi: Ankesën me numër protokoli 2150/2026 të datës 30.04.2026 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Konkursin me Nr. Reference: RN00014960 për pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës; Raportin me propozim për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm i datës 30.12.2024 nga Drejtorja për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore për Kryesinë e Kuvendit; Aplikacionin e ankuesi të datës 29.09.2024 me 7 faqe; Aplikacionin e datës 05.09.2024 të kandidatit T.B me 3 faqe; Përfundimin e datës 02.03.2025; Transkriptin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit ta datës 02.03.2026; Opinionin ligjor të datës

24.03.2026 të Drejtorisë për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit për Kryesinë e Kuvendit; Vendimin me Nr. 10-V-007 të datës 30.03.2026 të Kryesinë së Kuvendit; Transkriptin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit ta datës 30.03.2026; Shkresën nga CorrWatch; Reagimin publik nga Grupi për Stadiume Juridike dhe Politike i datës 02..04.2026 dhe 05.03.2026; Emailin e datës 03.04.2026 nga ankuesi për M.H; Emailin e datës 03.04.2026 nga M.H për E.P; Emailin e datës 03.04.2026 nga E.P për M.H; Emailin e datës 03.04.2026 nga M.H për ankuesin; Emailin e datës 02.04.2026 nga ankuesi për E.P; Emailin e datës 02.04.2026 nga E.P për ankuesin; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 05.05.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 14.05.2026; Njoftimin për kandidatët fitues i datë 26.11.2024.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ ka gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara, *sepse*:

Gjendja e çështjes

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton:

-Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 30.08.2024, ka shpallur konkursin me Nr. Ref: RN00014960, për pozitën e punës Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit, më afat aplikimi nga 31.08.2024 deri 29.09.2024.

- Pas përfundimit të procedurës së pranimit, Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Kuvendit të Kosovës më datë 26.11.2024 ka shpallur njoftimin për kandidatët e suksesshëm, gjegjësisht A.L. me 90.2 pikë dhe T.B. me 88.2 pikë.

- Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Kuvendin e Republikës së Kosovës, më datë 30.12.2024, paraqiti pranë Kryesisë së Kuvendit të Kosovës raportin përmbledhës të procedurës së zhvilluar së bashku më propozimin për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm.

-Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.03.2026, diskutoi si pikë e rendit të ditës për zgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu që, duke u bazuar në votimin e anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, rrjedha e votimit për ankuesin ka qenë dy (2) vota për, tri (3) vota kundër dhe një (1) abstenim, ndërsa, kandidati tjetër T.B. ka marrë tri (3) vota kundër dhe dy (2) abstenime dhe një anëtar i kryesisë nuk ka marr pjesë në votim.

-Duke qenë se asnjëri nga kandidatët nuk ka marrë numrin e mjaftueshëm të votave (shumicën) Kryesia e Kuvendit të Kosovës, më datë 30.03.2026, ka nxjerr Vendim me Nr. 10-V-007, ku sipas pikës I të dispozitivit konstatohet se asnjëri nga kandidatët e propozuar A.L, këtu ankuesi dhe T.B, nuk i morën votat e nevojshme për t'u zgjedhur në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm, ndërsa, në pikën II të dispozitivit është vendosur për ri-shpallje të konkursit lidhur më pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Kosovës.

Pretendimet ankimore

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me Nr. 10-V-007, të datës 30.03.2026, të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke pretenduar se akti i kontestuar karakterizohet me mungesë të bazës ligjore për rihapje të konkursit, sepse, procedura e pranimit përfundon më propozimin e kandidatëve fitues tek titullari/mbikëqyrësi, e qe në rastin konkret procedura për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit

të Kosovës ka përfunduar pasi që e njëjta ka kaluar të gjitha fazat, kështu që, një procedurë mund të përfundojë vetëm sipas nenit 47 paragrafi 11 të LZP-së si *lex speciales*. Shton se ri hapja e konkursit dhe mos përzgjedhja e një kandidati është në kundërshtim të plotë me LZP-en. Me tej, ankuesi pretendon se vendimi i kontestuar nuk përmban elementet e detyrueshme të aktit administrativ siç parashihet me nenin 47 të LPPA-së, pasi që akti nuk përben arsyetim dhe as këshilli juridike. Kërkon që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i kontestuar dhe të obligohet Kryesia e Kuvendit të Kosovës të vazhdojë procedurën duke përzgjedhur njërin nga kandidatët e propozuar.

Vlerësimi i Kolegjit

Duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë (tutje LZP) më të cilin përcaktohet se: *“4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë..”* rezulton fakti i pa kontestuar se të punësuarit në administratën e Kuvendit të Kosovës kanë statusin e veçantë të nëpunësit civilë, duke nënkuptuar së marrëdhënia e punës, më theks të veçantë procedura e rekrutimit rregullohet më akt të veçantë të brendshëm në ndërlidhje me ligjin bazik për zyrtarët publikë. Rrjedhimisht, mbi këtë përcaktim ligjor Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, më datë 01.03.2024, ka miratuar Rregulloren Nr. 08-RR-013 për Procedurën e Pranimi, Ankesat, Përbërjen e Komisionit Disiplinor, Transferimit dhe për Pezullimin e Nëpunësit Civil në Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovë.

Rrjedhimisht, në kuptim të bazueshmërisë së ankesës, Kolegji iu referua nenit 40, 41, 44 dhe 45 të Rregullores Nr. 08-RR-013 për Procedurën e Pranimi, Ankesat, Përbërjen e Komisionit Disiplinor, Transferimit dhe për Pezullimin e Nëpunësit Civil në Administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovë, më të cilat dispozita përcaktohet:

-Neni 40:1.*Procedura e pranimi për pozitën Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit të Republikës së Kosovës (ne tekstin në vijim: Sekretar i Përgjithshëm) zhvillohet nëpërmjet procesit përzgjedhës të bazuar në konkurrim të hapur, transparent, të drejtë dhe profesional. 2.Pranimi i aplikacioneve për pozitën Sekretari Përgjithshëm, behet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit..... 4.Perveç kërkesave në paragrafin 3 të këtij neni dhe kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me ligj, mund të kërkojnë edhe kërkesa specifike shtesë, të cilat shqyrtohen dhe miratohen paraprakisht nga Kryesia e Kuvendit.*

-Neni 41: 1.*Procedura e konkurrimit për pozitën e Sekretari të Përgjithshëm organizohet nga DMBNJ. 2.Kryetari i Kuvendit propozon fillimin e procedurës për pranimin e Sekretarit të Përgjithshëm. 3.Procedura e konkurrimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, në rastet kur pas mandatit të pare nuk propozohet vazhdimi i mandatit dhe pas përfundimit të mandatit të dytë sipas nenit 49 të Ligjit nr. 08/L-197 për zyrtarët publik, fillon se paku tre (3)muaj para përfundimi të mandatit.*

-Neni 44: ...8.*Lista e kandidateve fitues të vlerësuar nga Komisioni i pranimi, me pikët me të larta dhe mbi pragun minimal të 70 e më shumë për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidat fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga Kryesia e Kuvendit. Në rast se procedura e rekrutimit përfundon pa të paktën dy (2) kandidate fitues të vlerësuar mbi pragun minimal të 70 % të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, organizohet procedura e re rekrutimi. 9.Kryesia e Kuvendit përzgjedh njërin prej kandidateve nga paragrafi 8 i këtij neni dhe e propozon për emërim. Para se të emërohet kandidati i propozuar nga Kryesia e Kuvendit, DMBNJ bën verifikimin përfundimtar nëse kandidati i plotëson kushtet e aplikimit.*

-Neni 45 paragrafi 1 dhe 2: *1.Perzgjedhja përfundimtare dhe emërimi ne pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm behet ne pajtim me nenin 49 te Ligjit nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik. 2.DMBNJ, pas marrjes se pëlqimit me shkrim për përzgjedhjen e kandidatit fitues për emërim në pozitën Sekretar i Përgjithshëm dhe para dërgimit të Kryesia e Kuvendit, bën verifikimin përfundimtar të plotësimit të kushteve të aplikimit nga kandidati. Kryesia e Kuvendit me vendimet e arsyetuar përzgjedh kandidatin fitues, brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e shpallje se fituesve.*

Referuar kuadrit ligjor si më sipër, dhe në kontekst të pretendimit ankimor se organizmi i një procedure të re të rekrutimit për pozitën respektive mund të behët vetëm në rastet siç përcaktohet me nenin 47 paragrafi 11 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Kolegji konstaton se një procedurë e caktuar e pranimit mund të përfundoj në çdo fazë, duke filluar në fazën e verifikimit paraprak nëse asnjë nga kandidatet aplikues s'ka përmbushur kriteret formale për pozitën e shpallur, apo nëse testin më shkrim (faza e vlerësimit) nuk e kalon asnjë kandidat, rrethana këto që *Mutatis mutandis* aplikohen sikurse në rastin ku asnjë kandidatë nuk arrin 70 pikë, si pikë të nevojshme po tu konsideruar kandidat i suksesshëm, rrjedhimisht në çdo rast vie në shprehje instituti i përfundimit të procedurës pa kandidat fitues dhe mbi këtë bazë urdhërohet shpallje e re e konkursit.

Për më tepër, nisur nga rregullimi i veçantë më ligj i procedurës së emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës dhe marrë parasysh formën e përbërjes vendimmarrëse të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës si organ kolegjal, Kolegji rithekson faktin së procedura e përzgjedhjes së Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës i nënshtrohet procesit të votimit sipas nenit 20, paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores se Kuvendit të Kosovës Nr.08 -V- 349, të datës 28 korrik 2022, pra, nxjerrja/miratimi i një vendimi bëhet më shumicën e votave të anëtareve të pranishëm të Kryesisë, e në formë të njëjtë ishte proceduar votimi i dy kandidatëve të shpallur si të suksesshëm, mirëpo, duke qenë së asnjëri nga dy kandidatët nuk ka marrë pikët e nevojshme për emërim në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Kosovës, atëherë, më të drejtë, Kryesia e Kuvendit të Kosovës më aktin e kontestuar ka vendosur për shpalljen e konkursit të ri.

Përkitazi më pretendimin ankimor se vendimi i kontestuar nuk ka arsyetim dhe këshillë juridike, Kolegji i'u referua dispozitave ligjore të nenit 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, më të cilat përcaktohet se: **Neni 47** [Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar] *1. Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); .4. pjesën përmbyllëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmbyllëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë.... Neni 49* [Panevojshmëria e arsyetimit] *1. Arsyetimi i aktit të shkruar nuk është i nevojshëm kur: 1.1. përjashtohet shprehimisht me ligj; 1.2. akti administrativ i nxjerrë, sipas kërkesës, miraton në tërësi kërkesën e palës kërkuuese dhe nuk i cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale të tjetër, ose 1.3. akti administrativ i nxjerrë, sipas detyrës zyrtare, nuk cenon të drejtat apo interesat juridike të ndonjë pale.*

Nisur nga kuadri ligjor si më sipër, e meqenëse se në rastin konkret nuk kemi të drejtë të fituar qoftë nga ankuesi apo kandidati tjetër, pasi që të njëjtit janë shpallur vetëm si kandidatë të suksesshëm, Kolegji erdhi në përfundimin se mungesa e arsyetimit nuk e bënë aktin e kontestuar si të paligjshëm. Për me tepër, Vendimi Nr. 10-V-007, i datës 30.03.2026, i Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, është fakt që nuk përmban këshillë juridike, por, në mungesë të këtij elementi pala ankuese nuk humb të drejtën në mjet juridik, pasi që, një akt administrativ mund të kontestohet edhe në mungesë të këshillës juridike siç parashihet me nenin 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, 3. *Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj.* E në rastin konkret ankuesi ka shfrytëzuar të drejtën e ankimimit të Vendimit Nr. 10-V-007, të datës 30.03.2026, të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Përmbledhur si më lartë, Kolegji vlerëson së pretendimet ankimore nuk janë të bazuar, ndërsa vendimi i goditur më ankesë gjegjësisht Vendimi me Nr. 10-V-007, i datës 30.03.2026, i Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk vërtetohet të jetë i përshirë më shkelje ligjore, andaj, bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të nenit 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

A.nr.492/2026

Avdyl BEKTESHI

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtës

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.L;
- Organit të punësimit: Kryetares së Kuvendit, Kryesisë së Kuvendit dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Kuvendit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.